



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 152

Tiranë – E Hënë, 6 Tetor 2014

PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i Gjykatës
Kushtetuese
nr. 48, datë 24.9.2014

Me objekt: 1. Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 00-2013-2208, datë 14.11.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).
2. Pezullimin e vendimit nr. 2196, datë 5.12.2006 të Gjykatës së Rrethit Vlorë, lënë në fuqi me vendimin nr. 85, datë 5.2.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë deri në përfundimin e gjykimit të çështjes në Gjykatën Kushtetuese.....

7935

Vendim i Gjykatës
Kushtetuese
nr. 49, datë 29.9.2014

Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 143, datë 4.7.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të vendimit nr. 131, datë 12.4.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimit nr. 00-2013-942, datë 4.7.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).....

7938



VENDIM
Nr. 48, datë 24.9.2014
NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
 e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i	Gjykatës
Kushtetuese			
Sokol Berberi	anëtar	i	“ “
Vitore Tusha	anëtare	e	“ “
Altina Xhoxhaj	anëtare	e	“ “
Fatmir Hoxha	anëtar	i	“ “
Gani Dizdari	anëtar	i	“ “
Besnik Imeraj	anëtar	i	“ “
Fatos Lulo	anëtar	i	“ “
Vladimir Kristo	anëtar	i	“ “

me sekretare Edmira Babaj, në datat 20.5.2014, 24.6.2014 dhe 17.7.2014 mori në shqyrtim, në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 22 Akti, që i përket:

KËRKUES: Jorgji Minga, Marianthi Hoxha (Minga), Sofia Laze (Minga), të përfaqësuar nga avokat Thimjo Kondi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ikbale Kokoshi, Qazim Kokoshi, të përfaqësuar nga avokat Arqile Nini Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi, si i papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 00-2013-2208, datë 14.11.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

2. Pezullimi i vendimit nr. 2196, datë 5.12.2006 të Gjykatës së Rrethit Vlorë, lënë në fuqi me vendimin nr. 85, datë 5.2.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë deri në përfundimin e gjykimit të çështjes në Gjykatën Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 45 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve dhe të mbrojtësit të tyre, të cilët janë shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Ikbale Kokoshi dhe Qazim Kokoshi, dhe të mbrojtësit të tyre, të cilët kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës si dhe të subjektit të interesuar Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Subjektet e interesuara, Ikbale Kokoshi dhe Qazim Kokoshi, i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesë padi me objekt detyrimin e kërkuësve (palë e paditur në atë gjykim) t'i njohë si pronarë dhe për pasojë të lirojnë dhe dorëzojnë truallin me sipërfaqe 4.650 m² të ndodhur në lagjen Pavarësia Vlorë. Subjektet e interesuara kanë kërkuar gjithashtu vendosjen e masës së sigurimit të padisë.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. 2196, datë 5.12.2006 ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë. Detyrimin e kërkuësve që të njohin si pronarë dhe t'u dorëzojnë subjekteve të interesuara sipërfaqen e truallit prej 4.650 m² të ndodhur në lagjen “10 Korriku”, Vlorë. Ligjërimin e masës së sigurimit të padisë të vendosur më parë.

3. Kundër vendimit të lartpërmendur kanë paraqitur ankim kërkuësit dhe Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 85, datë 5.2.2010 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2196, datë 5.12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, fillimisht, me vendimin nr. 63, datë 25.2.2011 ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2196, datë 5.12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë të lënë në fuqi me vendimin nr. 85, datë 5.2.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

5. Me vendimin nr. 00-2013-2208, datë 14.11.2013, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuësve pasi është paraqitur jashtë afatit 30-ditor të parashikuar nga neni 443/2 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).



II

6. **Kërkuesit** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim “Gjykata”) duke pretenduar shfuqizimin e vendimit objekt kërkesë. Ata kanë parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

6.1. Gjykata e Lartë duke vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve me arsyetimin se është paraqitur jashtë afatit 30-ditor të parashikuar nga neni 443/2 i Kodit të Procedurës Civile (KPC) i ka cenuar atyre të drejtën e aksesit në gjykatë.

6.2. Kërkuesit kanë kërkuar gjithashtu edhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës së rrethit duke pretenduar se ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit:

- cenon të drejtat e pronësisë të kërkuesve;
- rrezikon tjetërsimin te të tretët të pronës nga ana e subjekteve të interesuara.

7. **Subjektet e interesuara, Ikbale Kokoshi dhe Qazim Kokoshi**, në mënyrë të përmbledhur, kanë prapësuar se depozitimi i rekursit për zënien e afatit nga ana e kërkuesve nuk është i shoqëruar me prova të pakontestueshme dhe të verifikuara në rrugë gjyqësore në mënyrë që të vërtetojnë këtë pretendim.

8. **Subjekti i interesuar, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë** ka prapësuar se në datën 5.2.2014 ka regjistruar me nr. 125 aplikimi, vendimin e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, bazuar në vendimet gjyqësore objekt shqyrtimi dhe në nenin 59 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012, kjo zyrë, në datën 10.4.2014 me urdhrin nr. 3016/1 prot. ka hequr kufizimin për pasurinë truall me sipërfaqe 3575 m², nr. 31/191, volum 37, faqe 145, si dhe ka lëshuar certifikatën përkatëse të pasurisë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për pretendimin e pezullimit të gjykimit

9. Kërkuesit kanë kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2196, datë 5.12.2006 të Gjykatës së Rrethit Vlorë, lënë në fuqi me vendimin nr. 85, datë 5.2.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë, deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor dhe marrjen e vendimit nga Gjykata

Kushtetuese. Sipas tyre, ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit cenon të drejtat e tyre të pronësisë si dhe rrezikon tjetërsimin te të tretët të pronës nga ana e subjekteve të interesuara.

10. Neni 45 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, parashikon se Gjykata kryesisht ose me kërkesë të palës, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancën plenare, urdhëron pezullimin e ligjit ose të aktit. Përgjithësisht vlerësimi i Gjykatës për të vendosur pezullimin ka të bëjë ekskluzivisht me rëndësinë (seriozitetin) dhe pariparueshmërinë e pasojave që vendimi i kundërshtuar mund të prodhojë *medio tempore*, para se Gjykata të shprehet në mënyrë përfundimtare mbi themelin e kërkesës.

11. Gjykata vlerëson se kërkesa për pezullimin e zbatimit të vendimit gjyqësor, objekt shqyrtimi, nuk gjen mbështetje në kërkesat e nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë si të pabazuar.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatë

12. Kërkuesit pretendojnë se kundër vendimit nr. 85, datë 5.2.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë, në datën 2.3.2010 kanë paraqitur recurs për zënien e afatit. Për këtë qëllim ata kanë depozituar një kopje të rekursit me vulë të njomë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe nënshkrimin (origjinal) të sekretares. Gjithsesi, kërkuesit parashatrojnë se nga kontrollet e kryera, ky akt nuk gjendet i administruar në dosjen gjyqësore për shkak të pakujdesisë së administratës gjyqësore. Në datën 12.5.2010, pasi janë njohur me arsyetimin e vendimit të gjykatës së apelit, kërkuesit kanë depozituar recurs të plotë. Ky akt i është bashkuar dosjes gjyqësore. Bazuar në datën e depozitimit të rekursit të plotë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2013-2208, datë 14.11.2013, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve për shkak të mosrespektimit të afatit 30-ditor të paraqitjes së tij. Në këto kushte,



kërkuesit pretendojnë se për shkak të një mosveprimi me dashje apo nga pakujdesia e nëpunësit përgjegjës të administratës gjyqësore, atyre u është mohuar e drejta e aksesit në Gjykatën e Lartë.

13. Sipas nenit 42 të Kushtetutës kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se kjo dispozitë sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'ju drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses. Gjykata ka konsideruar se sipas këtij neni, detyrimi për të garantuar të drejtën efektive të aksesit në gjykatë nuk nënkupton thjesht mungesën e një ndërhyrjeje, por mund të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve pozitive nga ana e shtetit. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 5, datë 6.3.2009; nr. 17, datë 18.7.2008; nr. 15, datë 17.4.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. E drejta e aksesit i garanton subjekteve të cenuar të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'iu siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Në këtë kuptim, ky standard përfshin të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, për çështjet civile, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore

për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 7, datë 27.2.2013, nr. 14, datë 26.3.2012; nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 14, datë 3.6.2009 dhe nr. 7 datë 11.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur gjithashtu se është detyrë e administratës gjyqësore të njoftojë ankuesin/rekursuesin kur dokumentacioni që shoqëron ankimin/rekursin është i paplotë. Ajo ka theksuar se e drejta e ankimit, ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë, nuk mund t'i cenohen kërkuesit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore (*shih vendimin nr. 32, datë 22.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Nga ana tjetër, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligje. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën qëllim në vetvete, por është në funksion të parimit të rëndësishëm të sigurisë juridike, si një nga përbërësit themelore të shtetit të së drejtës (*shih vendimet nr. 17, datë 19.6.2009; nr. 26, datë 15.12.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata për të verifikuar pretendimin e kërkuesve, si fakt me natyrë kushtetuese, që lidhet me të drejtën e aksesit në gjykatë të individit, me shkresën datë 18.3.2014 i ka kërkuar informacionin përkatës Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kjo e fundit me shkresë nr. 469 prot., dt. 27.3.2014 ka konfirmuar se origjinali i rekursit për zënien e afatit është depozituar nga kërkuesit në datën 2.3.2010 dhe se ai ndodhet në nëndosjen gjyqësore që i përket çështjes në fjalë. Po ashtu nga fleta e regjistrit të rekurseve, të po asaj gjykate, të datës 2.3.2010 rezulton se kërkuesit kanë paraqitur rekurs.

18. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se veprimet ose mosveprimet e parregullta të administratës gjyqësore nuk duhet t'i ngarkohen individit, i cili nuk mund të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së saj (administratës). Në këtë kuptim, Gjykata çmon se kërkuesve i është mohuar e drejta e aksesit në gjykatë dhe se pretendimi i tyre është i bazuar dhe duhet pranuar.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “P”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
 - Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2013-2208, datë 14.11.2013, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).
 - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo.

Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj.

VENDIM

Nr. 49, datë 29.9.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i	Gjykatës
Kushtetuese			
Sokol Berberi	anëtar	i	“ “
Vitore Tusha	anëtare	e	“ “
Altina Xhoxhaj	anëtare	e	“ “
Fatmir Hoxha	anëtar	i	“ “
Gani Dizdari	anëtar	i	“ “
Besnik Imeraj	anëtar	i	“ “
Fatos Lulo	anëtar	i	“ “
Vladimir Kristo	anëtar	i	“ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 10.6.2014 mori në shqyrtim, në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 29 Akti, që i përket:

KËRKUES: Kastriot Jaupi, i përfaqësuar me prokurë të posaçme nga avokat Shuaip Syri.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e

Faqe | 7938

Përgjithshme, përfaqësuar me autorizim nga z. Kujtim Luli.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtuashëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 143, datë 4.7.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i vendimit nr. 131, datë 12.4.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimit nr. 00-2013-942, datë 4.7.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 18 dhe 25 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 2, 3 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesit, i cili është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, e cila ka kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 143, datë 4.7.2003, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur:

a) Deklarimin fajtor të kërkesit Kastriot Jaupi për veprën penale të vrasjes me paramendim në bashkëpunim dhe me përdorim të armës së zjarrit të ushtarakut Ilir Ngresi, të parashikuar nga nenet 79/c dhe 25 të Kodit Penal (KP) në lidhje me nenin 50/gj të KP-së dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

b) Deklarimin fajtor të kërkesit Kastriot Jaupi për veprën penale të vrasjes me paramendim në bashkëpunim të mbetur në tentativë të ushtarakut Ilir Ngresi, të parashikuar nga nenet 79/c, 25, 22, 50/gj të KP-së dhe dënimin e tij me 20 vjet burgim.

c) Deklarimin fajtor të kërkesit Kastriot Jaupi për veprën penale të vrasjes me paramendim në bashkëpunim të mbetur në tentativë të policit Artimond Jaupi, të parashikuar nga nenet 79/c, 25, 22, 50/gj të KP-së dhe dënimin e tij me 20 vjet burgim.

d) Deklarimin fajtor të kërkesit Kastriot Jaupi për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuar nga neni 278/2 i KP-së dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim.



dh) Në zbatim të nenit 55/1 të KP-së, në bashkim të dënimeve, e ka dënuar përfundimisht me burgim të përjetshëm.

2. Gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar në mungesë të kërkuetit, i mbrojtur nga avokat Sh.S. i zgjedhur me prokurë të posaçme, nga familjarët. Ky vendim ka marrë formë të prerë pasi kundër tij nuk u paraqit ankim.

3. Kërkueti pretendon se ka marrë dënimin për vendimin e lartpërmendur në datën 20.10.2008, ditën kur u bë ekstradimi i tij në Shqipëri. Për këtë arsye, në datën 24.10.2008 kërkueti ka paraqitur kërkesë për rivendosjen në afat të ankimit ndaj vendimit nr. 143, datë 4.7.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

4. Me vendimin nr. 353, datë 20.11.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka rrëzuar kërkesën për rivendosjen në afat të kërkuetit. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 24, datë 16.2.2009.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2009-102 (370), datë 1.7.2009 ka vendosur ndryshimin e dy vendimeve të gjykatave të faktit dhe duke e zgjidhur çështjen në fakt, ka pranuar kërkesën e Kastriot Jaupit, për të paraqitur ankim kundër vendimit nr. 143, datë 4.7.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

6. Me vendimin nr. 131, datë 12.4.2010, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 143, datë 4.7.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kundër këtij vendimi kërkueti ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

7. Me vendimin nr. 00-2013-942, datë 4.7.2013 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit pasi nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

II

8. **Kërkueti** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të tre shkallëve të gjykimit, duke pretenduar se ato janë rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor. Ai ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, këto shkaqe:

8.1. Gjykimi në shkallë të parë është bërë në mungesë të kërkuetit. Ai nuk është njoftuar

asnjëherë se ndaj tij po zhvillohej një proces penal dhe po gjykohej në mungesë, edhe pse kishte të dhëna të mjaftueshme mbi vendndodhjen e tij. Në këto kushte, i pandehuri nuk ka pasur mundësi që të japë vetë deklaratat, apo të parashtrrojë shpjegimet e tij si dhe ka humbur të drejtat e tij për t'u dëgjuar lidhur me fajësinë.

8.2. Gjykatat e shkallës së parë dhe apelit kanë shkelur parimin e ligjshmërisë në marrjen e provave, të sanksionuar nga neni 32/2 i Kushtetutës, pasi provat në proces janë marrë në kundërshtim me parashikimet e dispozitave të KPP-së.

8.3. Është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë, i sanksionuar në nenin 30 të Kushtetutës, si pasojë e cenimit të parimit *in dubio pro reo*, sipas të cilit çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Mbështetja e vendimit të shkallës së parë në prova të pavlefshme apo në fakte dhe ngjarje të dëgjua apo të mësuara nga persona të tretë, rrëzimi pa shkaqe të arsyeshme nga ana e gjykatës së apelit e kërkesës për përsëritje të shqyrtimit gjyqësor, mënyra e arsyetimit të vendimeve të gjykatave të faktit, krijon bindjen se gjykatat e kanë paragjykuar kërkuetin, pa u shpallur akoma fajtor, si autor të veprës penale.

8.4. Është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e paanshme. Gjykata e Apelit nuk mori parasysh kërkesën e mbrojtësit të kërkuetit për transferimin e çështjes nga ajo gjykatë në një gjykatë tjetër, për shkakun se vëllai i viktimës Ilir Ngresi, gjyqtari S.N. ushtron detyrën e gjyqtarit në të njëjtën gjykatë.

8.5. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i apelit nuk plotësojnë elementet që ka identifikuar jurisprudenca kushtetuese lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit. Asnjë nga vendimet e gjykatave të faktit nuk ka analizuar se cilat janë veprimet e organizatorit dhe ndihmës ekzekutorit të veprës penale dhe më pas nuk është provuar nëse ato janë kryer nga kërkueti.

8.6. Është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Gjykata e apelit pavarësisht pretendimeve të kërkuetit për pavlefshmërinë e provave të mbledhura gjatë fazës së hetimit si dhe faktit që ai ishte gjykuar në mungesë në shkallë të parë, nuk ka pranuar



kërkesën për përsëritje të shqyrtimit gjyqësor. Në këtë mënyrë kërkuesi nuk ka pasur mundësinë për t'u ballafaquar me provat.

8.7. Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë duhet të mbante qëndrim në shqyrtimin e pretendimeve të kërkuetit, kur nga ky i fundit janë pretenduar shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat e faktit si dhe shkaqe të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Kjo imponohet për shkak të pozicionit të saj si gjykatë e ligjit në kontrollin dhe respektimin e standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta.

9. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

9.1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka marrë të gjitha masat dhe ka zbatuar të gjitha rregullat procedurale për kërkimin e të pandehurit dhe për njoftimin e tij nëpërmjet familjarëve. Për pasojë, kërkuesi është gjykuar në mungesë, si gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ashtu edhe në Gjykatën e Apelit Vlorë, për shkak të heqjes dorë vullnetarisht nga e drejta për të marrë pjesë në procesin penal në ngarkim të tij.

9.2. Provat nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm janë marrë në mënyrë të ligjshme, ndërsa pretendimet e kërkuetit lidhur me marrjen e tyre, në thelb, kanë të bëjnë me kuptimin, interpretimin dhe zbatimin e ligjit procedural penal, të cilat janë çështje që i përkasin juridiksionit të zakonshëm.

9.3. Nuk rezulton ndonjë e dhënë që të tregojë se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykata e Apelit Vlorë e kanë filluar procesin me paragjykimin se kërkuesi i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet si dhe nuk rezulton që gjykatat të kenë kaluar barrën e provës nga prokurori tek i gjykuari.

9.4. Gjykimi i kërkuetit në godinën e Gjykatës së Apelit Vlorë nga tre gjyqtarë të deleguar nga Gjykata e Apelit Korçë nuk cenon parimin e paanshmërisë. Për më tepër ky pretendim i kërkuetit nuk është ngritur në nivel kushtetues për faktin se mungojnë argumentet për të provuar që gjyqtarët që kanë gjykuar çështjen nuk kanë ofruar garanci të mjaftueshme dhe/ose kanë pasur interesa personale në atë çështje.

9.5. Vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm janë të bazuar në një analizë të

mjaftueshme të pretendimeve të palëve, nëpërmjet vlerësimit në harmoni të provave shkresore dhe me dëshmitarë duke respektuar kërkesat procedurale formale dhe substanciale për arsyetimin e vendimit.

9.6. Kërkuesi nuk është vënë në disavantazh gjatë gjykimit në dy shkallët e para, pasi ai ka qenë i përfaqësuar nga i njëjti mbrojtës i zgjedhur nga familjarët, fillimisht, e më pas prej tij, i cili ka përgatitur një mbrojtje efektive, ka parashtruar kërkesa për marrjen e provave, ka komentuar dhe kundërshtuar, përmes debatit kontradiktor, provat e paraqitura nga akuza.

9.7. Arsyetimi i vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në rastet kur nuk janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit të rregullt gjyqësor, nuk paraqet mangësi pasi forma e arsyetimit të vendimeve të mospranimit të rekursit është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

10. Gjykata, përpara se të shqyrtojë bazueshmërinë e pretendimeve të kërkuetit thekson, paraprakisht, se ajo i vlerëson këto pretendime në drejtim të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, në aspektin e detyrimeve që duhet të përmbushin gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në respekt të së drejtës së mbrojtjes.

11. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 35, datë 20.12.2005, nr. 14, datë 17.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është



rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19 datë 2.4.2012; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 36, datë 25.7.2013; nr. 52, datë 2.12.2013, nr. 3, datë 23.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në këtë kuptim, Gjykata duhet të investohet vetëm nëse konstaton shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar dhe riparuar nga Gjykata e Lartë. Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006, nr. 19 datë 2.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Bazuar në këto vlerësime, më poshtë Gjykata do të analizojë secilin prej pretendimeve të ngritura nga kërkuesi.

A. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar gjatë gjykimit.

14. Kërkuesi pretendon se nuk është njoftuar për procesin në ngarkim të tij gjatë gjykimit në shkallë të parë edhe pse nga mbrojtësi i tij, i caktuar nga familjarët, që në fillim të gjykimit është deklaruar vendndodhja e tij jashtë shtetit.

15. Nga dosja gjyqësore rezulton se gjatë gjykimit në shkallë të parë përfaqësuesi ligjor i kërkuesit ka deklaruar se kërkuesi ndodhej në burg në Spanjë dhe ka kërkuar njoftimin e tij. Gjykata ka vazhduar gjykimin në mungesë, meqë më parë, me vendimin nr. 57, datë 10.9.2002, ishte deklaruar ikja e kërkuesit. Ky i fundit është rivendosur në afat ndaj vendimit të shkallës së parë me anë të vendimit nr. 00-2009-102 (370), datë 1.7.2009 të Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë.

16. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka vlerësuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin kushtetues dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 21, datë 1.10.2008; nr. 40, datë 22.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata në praktikë të vazhdueshme nuk ka pranuar pretendimet e individit për cenimin e parimeve kushtetuese për një proces të rregullt

ligjor në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë ka plotësuar apo korrigjuar mangësitë e gjykatave të shkallëve më të ulëta në garantimin e këtyre standardeve (*shih vendimin nr. 21, datë 1.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se në rastin konkret, përderisa kërkuesi është rivendosur në afat dhe efektivisht ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të shkallës së parë, pretendimi i tij se gjykata e shkallës së parë nuk kishte respektuar nenin 142 të KPP-së lidhur me njoftimin e të pandehurit jashtë shtetit, nuk e bën procesin të parregullt në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të ligjshmërisë në marrjen e provave.

18. Kërkuesi pretendon se prova e vetme, dëshmia e shtetasit B.H., ku bazohet gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit, për veprën penale të vrasjes me paramendim në bashkëpunim të mbetur në tentativë të ushtarakut Ilir Ngresi, dhe të policit Artimond Jaupi, është e pavlefshme. Sipas kërkuesit, deklarata e këtij dëshmitari është marrë gjatë hetimeve paraprake (dt. 23.11.2000) sepse ai nuk u paraqit asnjëherë para gjykatës dhe nuk u arrit të bëhej sigurimi i saj në përputhje me nenet 317/2, 319, 329 dhe 331 të KPP-së. Kjo deklaratë nuk është konform nenit 99 të KPP-së sepse mungon dokumenti i identifikimit dhe nënshkrimi i dëshmitarit. Po ashtu dëshmia është e pabesueshme sepse më parë shtetasi B.H. ka punuar si polic në komisariatit e policisë së Beratit ku ka punuar dhe viktime Ilir Ngresi. Dëshmia tjetër e shtetasit R.B. është e pavlefshme sepse mungon dokumenti i identifikimit. Edhe ky i fundit nuk është paraqitur në gjykatë. Pra, provat nuk i janë nënshtruar debatit gjyqësor sipas nenit 152 të KPP-së.

19. Lidhur me veprën tjetër penale për të cilën është deklaruar fajtor kërkuesi, atë të veprës penale të vrasjes me paramendim në bashkëpunim dhe me përdorim të armës së zjarrit, të ushtarakut Ilir Ngresi, kërkuesi pretendon se dëshmitarëve që janë paraqitur në gjykatë, në kundërshtim me nenet 361/4 dhe 362 të KPP-së, u janë lexuar çfarë kanë deklaruar përpara oficerit të policisë gjyqësore; të gjitha procedurat e njohjes me fotografi të kërkuesit



(gjatë hetimeve paraprake) janë bërë në kundërshtim me nenet 128/c dhe 129 të KPP-së, pasi nuk është siguruar mbrojtja me avokat edhe kryesisht e kërkuesit, si dhe në kundërshtim me nenet 171 dhe 172 të KPP-së, sepse në to mungon pasqyrimi i hollësishëm i kërkesave ligjore; procesverbalet për deklaratimet nga persona që tregojnë rrethanat e hetimit dhe ato të paraqitjes për njohje për dëshmitarët analfabetë B.M., Sh.M., Sh.O. dhe S.M janë të pavlefshëm sepse nënshkrimet nuk janë bërë sipas përcaktimeve të nenit 99 të KPP-së; procesverbalet për deklaratimet nga persona që tregojnë rrethanat e hetimit të shtetasve I.Zh. dhe Z.Zh., bazuar në nenin 158 të KPP-së, nuk janë të vlefshme pasi këta dy shtetas janë vëllezër të D.Zh. i akuzuar për vrasjen e viktimës Ilir Ngresi.

20. Sipas jurisprudencës kushtetuese, tashmë të konsoliduar, marrja e provave në mënyrë të ligjshme përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe nga neni 6 i KEDNJ- së. Parimi bazë kushtetues që lidh provat me procesin e rregullt është i sanksionuar në nenin 32/2 të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

21. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se jo për të gjitha provat, ku gjykatat kanë mbështetur vendimet e tyre, janë zbatuar me rigorozitet dispozitat e KPP-së në lidhje me marrjen e tyre. Gjithsesi duhet pasur parasysh se parimi i marrjes së provave në mënyrë të ligjshme është trajtuar nga jurisprudenca e kësaj Gjykate dhe e GJEDNJ-së, në drejtim të respektimit të së drejtës për t'u mbrojtur. Gjykata ka theksuar se për të përcaktuar nëse procesi ka qenë i rregullt, duhet kontrolluar nëse e drejta e mbrojtjes është respektuar dhe duhet verifikuar në veçanti nëse kërkuesit i është dhënë mundësia për të vënë në dyshim autenticitetin e provave dhe kundërshtuar përdorimin e tyre (*shih vendimin nr. 47, datë 7.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Referuar çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe ajo e Apelit Vlorë arsyetojnë se për fajësinë e kërkuesit janë bazuar, jo vetëm në provat e kundërshtuara si të pavlefshme nga kërkuesi, por

edhe në një sërë provash të tjera të administruara gjatë gjykimit, si provat materiale, shkresore, aktet e ekspertimit etj.

23. Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkuesi nuk ka arritur të paraqesë argumente të mjaftueshme përse faktet e lartpërmendura i kanë cenuar të drejtën e mbrojtjes dhe që, për rrjedhojë, e bëjnë procesin të cenueshëm nga pikëpamja kushtetuese.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë

24. Kërkuesi pretendon cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë nga gjykatat e faktit për shkak se vendimi i shkallës së parë është mbështetur në prova të pavlefshme apo në fakte dhe ngjarje të dëgjua apo mësuara nga persona të tretë dhe se gjykata e apelit ka rrëzuar pa shkaqe të arsyeshme kërkesën për përsëritje të shqyrtimit gjyqësor. Po ashtu mënyra e arsyetimit të vendimeve të këtyre gjykatave krijon bindjen se ato e kanë paragjykuar kërkuesin, pa u shpallur fajtor, si autor të veprës penale.

25. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementët përbërës të procesit të rregullt ligjor. Ky parim parashikohet në nenin 30 të Kushtetutës sipas të cilit “Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë”. Gjykata është shprehur edhe më parë, se parimi i prezumimit të pafajësisë do të thotë që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte që duhet të provohen nga akuza (*shih vendimin nr. 9, datë 28.4.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) është shprehur se prezumimi i pafajësisë kërkon, ndër të tjera, që kryerja e detyrave nga anëtarët e një gjykate, nuk duhet të fillojë me idenë e paracaktuar se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet, se barra e provës i takon prokurorit dhe çdo dyshim duhet të jetë në favor të të akuzuarit. Është detyrë e prokurorit që të informojë të akuzuarin për çështjen kundër tij, në mënyrë që ai të mund të



përgatisë e paraqesë mbrojtjen dhe të kundërshtojë provat të cilat mjaftojnë për ta dënuar atë. Parimi i prezumimit të pafajësisë mund të shkelet edhe në mungesë të një deklarimi formal, mjafton të ekzistojë një arsyetim i cili të sugjerojë se gjykata e konsideron të akuzuarin si fajtor si edhe kur barra e provës kalon nga prokurori te mbrojtja (*shih vendimet Minelli kundër Zvicrës; John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, 8 shkurt 1996; Telfner kundër Austrisë 20 qershor 2001 të GJEDNJ-së*).

27. Në rastin në shqyrtim, nga vlerësimi në tërësi i materialeve të paraqitura, Gjykata çmon se nuk rezulton asnjë e dhënë e cila të tregojë se gjykatat e zakonshme, që kanë shqyrtuar çështjen, e kanë filluar procesin me paragjykimin se kërkuesi e ka kryer veprën penale apo e kanë konsideruar të akuzuarin fajtor para dhënies së një vendimi përfundimtar për fajësinë e tij. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se nuk rezulton që gjykatat e zakonshme, të kenë kaluar gjatë procesit, barrën e provës nga prokurori tek i pandehuri. Për pasojë, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar në argumente.

Ç. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme

28. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Apelit Vlorë nuk mori parasysh kërkesën e mbrojtësit të tij për transferimin e çështjes nga ajo gjykatë në një gjykatë tjetër, për shkakun se vëllai i viktimës Ilir Ngresi, gjyqtari S.N. ushtron detyrën e gjyqtarit në të njëjtën gjykatë.

29. Gjykata, në praktikë të vazhdueshme, ka theksuar rëndësinë e gjyqimit nga një gjykatë e paanshme, me qëllim respektimin e të drejtave të palëve gjatë gjithë procesit. Kështu, ajo ka theksuar se në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, ekzistojnë dy teste për të vlerësuar nëse një gjykatë është e paanshme: i pari, konsiston në përcaktimin e bindjes personale të gjyqtarit në një çështje konkrete. Ndërsa testi i dytë lidhet me vlerësimin nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të ligjshëm në këtë drejtim. Përjashtimi i këtyre dyshimeve është garanci për besimin që duhet të frymëzojnë gjykatat në një shoqëri demokratike për publikun dhe mbi të gjitha, për palët në procesin gjyqësor (*shih vendimin nr. 18, datë 3.5.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Sipas Gjykatës, parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimi prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe të marrë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Në shtetin e së drejtës, kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që duhet të krijojnë në çdo rast në shoqërinë demokratike jo vetëm palët në gjykim, por çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimin nr. 16, datë 25.4.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në kuadrin e parimeve kushtetuese që qëndrojnë në themel të një procesi të rregullt gjyqësor, respektimi i parimit të paanshmërisë mundëson krijimin e besimit të gjyqësori me qëllim që drejtësia jo vetëm të bëhet, por dhe të shihet që po bëhet. Në demokraci, ligjshmëria e rolit të gjyqtarit varet jo vetëm nga qenia e tij, por dhe nga shfaqja e tij i paanshëm dhe i pavarur, duke qenë se roli i tij gjatë gjyqimit duhet të jetë pasiv dhe *super partes* (*shih vendimin nr. 23, datë 4.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Në rastin në shqyrtim, Kryetarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, bazuar në nenin 21, të ligjit 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor”, i ka kërkuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë, delegimin e tre gjyqtarëve për shqyrtimin e çështjes sepse gjyqtarët e atij institucioni kanë pengesë për shqyrtimin e saj për shkak të detyrës si gjyqtar i asaj gjykate të vëllait të viktimës, z. S.N. Me vendimin nr. 254/4, datë 2.11.2009, KLD-ja ka vendosur delegimin e tre gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë në gjykimin e çështjes.

33. Në datën 22.1.2010, kërkuesi, për të njëjtën arsye, bazuar në nenin 94 të KPP-së, ka paraqitur kërkesë për transferimin e çështjes në një gjykatë apeli tjetër. Ndërkohë Gjykata e Apelit Vlorë, mbështetur në nenin 96 të KPP-së ka vazhduar gjykimin përderisa “në adresë të saj nuk kishte një vendim pezullimi të gjyqimit”.



34. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se fakti që çështja në Gjykatën e Apelit Vlorë është shqyrtuar nga tre gjyqtarë të deleguar nga një gjykatë tjetër përmbush elementët e parimit të paanshmërisë. Gjykata e apelit ka marrë të gjitha masat e nevojshme në funksion të dhënies së garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm me qëllimin të mënjanimin prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim.

D. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga gjykatat e faktit.

35. Sipas kërkuarit vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i apelit nuk plotësojnë elementet që ka identifikuar jurisprudenca kushtetuese lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit. Asnjë nga vendimet e gjykatave të faktit nuk ka analizuar se cilat janë veprimet e organizatorit dhe ndihmës ekzekutorit të veprës penale dhe më pas nuk është provuar se ato janë kryer nga kërkuari.

36. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42, 142/1 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 25, datë 10.6.2011 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, po ashtu, ka çmuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të

bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 20, datë 13.4.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjithë elementet e sipërpërmendur. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Bazuar në elementet e trajtuar nga jurisprudenca kushtetuese në lidhje me arsyetimin e vendimit, Gjykata vlerëson se përderisa gjykatat e faktit kanë paraqitur faktet dhe rrethanat e çështjes dhe provat ku mbështetet vendimi, ky pretendim i kërkuarit nuk është i bazuar.

Dh. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit si dhe të së drejtës për një proces të rregullt ligjor në Gjykatën e Lartë.

39. Kërkuari pretendon se Gjykata e Apelit Vlorë, pavarësisht pretendimeve të kërkuarit për pavlefshmërinë e provave të mbledhura gjatë fazës së hetimit (të lartpërmendura) si dhe faktit që ai ishte gjykuar në mungesë në shkallë të parë, nuk ka pranuar kërkesën për përsëritje të shqyrtimit gjyqësor. Në këtë mënyrë, kërkuari nuk ka pasur mundësinë për t'u ballafaquar me provat.

40. Lidhur me parimin e barazisë së armëve, në jurisprudencën e Gjykatës është theksuar se, veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe lidhur ngushtë me këto, mbrojtja e të pandehurit, e garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishëm e thelbësorë të



procesit të rregullt ligjor. Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata, me objektivitet e paanësi (*shih vendimet nr. 19, datë 12.6.2003 dhe nr. 19, datë 18.9.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Lidhur me parimin e barazisë së armëve, Gjykata mban qëndrimin se provat paraqiten dhe marrin vlerën e tyre në debatin gjyqësor, ku secila palë ka mundësi për të paraqitur argumentet e veta në një pozitë jo më pak të favorshme se pala tjetër (*shih vendimet nr. 19, datë 18.9.2008 dhe nr. 7, datë 27.4.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Nga materialet e dosjes, Gjykata konstaton se edhe pse gjykimi në shkallë të parë është bërë në mungesë të kërkuesit dhe disa prej pretendimeve të tij mbi mënyrën e parregullt të marrjes së provave gjejnë pasqyrim në materialet e dosjes, Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka pranuar kërkesën për përsëritjen e hetimit gjyqësor duke arsyetuar se “veprimet hetimore që kërkonte avokati të kryheshin ishin kryer gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe nuk ishin kërkime të bëra në këtë gjykim apo të refuzuara pa ndonjë shkak të ligjshëm nga gjykata”.

42. Gjithashtu, Gjykata vëren se ky pretendim është ngritur nga kërkuesi edhe në rekurs dhe Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e tij, nuk i ka dhënë përgjigje.

43. Neni 427/4 i KPP-së parashikon se gjykata vendos përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor kur vërtetohet se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në shkallë të parë, sepse nuk ka marrë dijeni ose nuk ka mundur të paraqitet për shkaqe ligjore.

44. Gjykata, në rastin konkret, respektimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit e sheh të lidhur ngushtë me detyrimin e Gjykatës së Lartë për të marrë në shqyrtim këtë pretendim si dhe, në respekt të parimit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, për t'i dhënë atij përgjigje. Në këto kushte, Gjykata vlerëson të analizojë cenimin e parimit të barazisë së armëve, në kuadër të mosrespektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor në Gjykatën e Lartë, të pretenduar nga kërkuesi. Lidhur me këtë të fundit, kërkuesi parashtron se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë edhe pse në prezencë të shkaqeve ligjore dhe kushtetuese të

ngritura në rekurs, nuk e kaloi çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore dhe nuk i dha përgjigje problemeve juridike të ngritura në rekurs.

45. Lidhur me vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomë këshillimi dhe, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata është shprehur tashmë se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit, për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet n. 19, datë 19.7.2005; nr. 22, datë 6.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Bazuar në sa më sipër, Gjykata çmon se është atribut i gjykatave të zakonshme të shqyrtojnë nëse në rastin konkret është zbatuar apo jo neni 427 i KPP-së. Gjithsesi, përdërisa ky pretendim i kërkuesit lidhet me cenimin e standardeve kushtetuese, të tilla si e drejta e aksesit në gjykatë dhe barazia e armëve, në respekt të parimit të subsidiaritetit të lartpërmendur, Gjykata e Lartë detyrohej t'i jepte atij përgjigje. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

47. Në përfundim, Gjykata vlerëson se disa nga shkeljet procedurale të konstatuara gjatë gjykimit gjejnë pasqyrim në dosjen gjyqësore dhe kanë të bëjnë me parime të rëndësishme të procesit të rregullt. Për pasojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit lidhur me antikushtetushmërinë e procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për gjithë arsyet e lartpërmendura, është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “P”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,



VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës¹.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2013-942, datë 4.7.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo, Fatos Lulo, Besnik Imeraj.

Anëtarë kundër: Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj.

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice.

2. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka pranuar kërkesën për përsëritje të shqyrtimit gjyqësor dhe në këtë mënyrë, ai nuk ka pasur mundësinë për t'u ballafaquar me provat. Sipas tij, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë edhe pse në prezencë të shkaqeve ligjore dhe kushtetuese të ngritura në rekurs, nuk e kaloi çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore dhe nuk i dha përgjigje problemeve juridike të ngritura në rekurs (*shih prg. 39 dhe 44 të vendimit*).

3. Nëpërmjet arsytimit të saj, shumica, në rastin konkret, respektimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit e ka parë të lidhur ngushtë me detyrimin e Gjykatës së Lartë për të marrë në shqyrtim këtë pretendim si dhe, në respekt të parimit të arsytimit të vendimeve gjyqësore, për t'i dhënë atij përgjigje. (*prg. 44 i vendimit*). Ajo ka konstatuar se pretendimi për përsëritjen e hetimit gjyqësor nga Gjykata e Apelit është ngritur nga kërkuesi edhe në rekurs dhe Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e tij, nuk i ka dhënë përgjigje (*prg. 42 i vendimit*). Shumica duke rikonfirmuar qëndrimin e saj lidhur me vendimet e dhëna nga

Gjykata e Lartë në dhomë këshillimi dhe, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, është shprehur tashmë se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit, për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*prg. 45 i vendimit*). Sipas shumicës, përderisa ky pretendim i kërkuesit [nënkupto: përsëritja e hetimit gjyqësor] lidhet me cenimin e standardeve kushtetuese, të tilla si e drejta e aksesit në gjykatë dhe barazia e armëve, në respekt të parimit të subsidiaritetit të lartpërmendur, Gjykata e Lartë detyrohej t'i jepte atij përgjigje. Si konkluzion, ajo ka çmuar se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsytimit të vendimeve gjyqësore (*prg. 46 i vendimit*).

4. Nuk pajtohem me këtë përfundim të shumicës pasi, në vlerësimin tim, ashtu siç jam shprehur edhe me mendim pakice në vendimet nr. 37, datë 30.6.2014; nr. 4, datë 5.2.2014 dhe nr. 3, datë 23.1.2014, Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje kërkuesit në vendimin e saj, të marrë në dhomë këshillimi. Ky qëndrim mbështetet në jurisprudencën e Gjykatës, sipas së cilës, arsytimi i kufizuar i vendimit të marrë në dhomën e këshillimit nuk përbën cenim të procesit të rregullt ligjor. Kjo formë arsytimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimet nr. 34, datë 12.7.2013; nr. 108, datë 3.10.2012 dhe nr. 17, datë 17.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese; vendimin nr. 143, datë 7.12.2011, të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

¹ Gjyqtarët G. Dizdari, B. Imeraj dhe F. Lulo votuan edhe për shfuqizimin e vendimit nr. 131, datë 12.4.2010 të Gjykatës së Apelit Vlorë.



5. Edhe GJEDNJ-ja ka theksuar se: “detyrimi që ka gjykata vendase për të arsyetuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Masa e arsyetimit të vendimit varet nga natyra e vendimit në fjalë” (...) “arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, në mënyrë të nënkuptuar evidenton se aplikanti nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës. Gjykata vëren se, kur një Gjykatë e Lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës” (*Marini kundër Shqipërisë, datë 18.12.2007, §105-106; Mishgjoni kundër Shqipërisë, datë 7.12.2010, § 51*).

6. Nga arsyetimi i shumicës nënkuptohet se, në rastin e ngritjes në rekurs të pretendimeve që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, Gjykata e Lartë, kur nuk e pranon rekursin, duhet t’u japë përgjigje këtyre pretendimeve (*shih prg. 35 të vendimit*). Në një arsyetim *a contrario*, bazuar në qëndrimin e mësipërm, nëse në rekurs nuk ngrihen pretendime që kanë të bëjnë me shkelje të parimeve themelore të procesit gjyqësor, Gjykata e Lartë nuk është e detyruar t’u japë përgjigje, pasi në këto raste është i mjaftueshëm një arsyetim i kufizuar, që e përmbush standardin kushtetues të arsyetimit. Ky lloj diferencimi në trajtimin e arsyetimit, i lidhur me natyrën e pretendimeve të ngritura në rekurs, është bërë nga shumica pa parashtruar motivet përse arsyetimi i kufizuar konsiderohet i rregullt, në aspektin kushtetues, në disa raste, dhe i parregullt në raste të tjera.

7. Me qëndrimin e saj shumica ka lënë shteg për një lloj ndërhyrjeje të Gjykatës Kushtetuese në rolin vlerësues të Gjykatës së Lartë. Kështu shumica, në rastin konkret, ka vlerësuar përmbajtjen e rekursit, konkretisht duke identifikuar natyrën e pretendimeve të ngritura në të dhe duke i imponuar Gjykatës së Lartë argumentimin në lidhje me këto pretendime. Konkretisht shumica, pasi ka çmuar se është atribut i gjykatave të zakonshme të shqyrtojnë

nëse në rastin konkret është zbatuar apo jo neni 427 i KPP-së, pra përsëritja e hetimit gjyqësor nga gjykata e apelit, ka konkluduar se përderisa ky pretendim i kërkuesit lidhet me cenimin e standardeve kushtetuese, Gjykata e Lartë detyrohej t’i jepte atij përgjigje. Vlerësimi i rekursit është atribut i Gjykatës së Lartë, e cila vlerëson pretendimet e ngritura në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë edhe pretendimi i kërkuesit, në rastin konkret, ka të bëjë me çështje ligjore të cilat i përkasin juridiksionit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Vlerësimi i procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, në këndvështrim të respektimit të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të bëhet nga Gjykata gjithmonë brenda kuadrit të kompetencave të saj, çka përjashton vlerësimin e përmbajtjes së rekursit dhe detyrimin e Gjykatës së Lartë për të ndjekur mënyra të ndryshme për vlerësimin e pretendimeve.

8. Gjithashtu, me qëndrimin e saj shumica krijon paqartësi për sa i përket mundësisë që ka kërkuesi për ta goditur për antikushtetutshmëri të njëjtin vendim pas rigjykimit në Gjykatën e Lartë. Për pasojë, qëndrimi i shumicës nuk i shërben efektivitetit të shqyrtimit kushtetues dhe respektimit të së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

9. Si përfundim, për sa më lart, ndryshe nga shumica, çmoj se në rastin konkret nuk është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, ndaj kërkesa e paraqitur nga kërkuesi duhet të ishte rrëzuar.

Anëtar: Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se jam kundër qëndrimit të shumicës, që ka pranuar kërkesën e paraqitur nga kërkuesi Kastriot Jaupi dhe ka shfuqizuar vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vlerësoj të parashtror argumentet e mia si gjyqtare në pakicë.

2. Kërkuesi ka pretenduar para Gjykatës Kushtetuese cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi Gjykata e Apelit Vlorë, pavarësisht pretendimeve për pavlefshmërinë e provave të mbledhura gjatë



fazës së hetimit si dhe faktit që ai ishte gjykuar në mungesë në shkallë të parë, nuk ka pranuar kërkesën për përsëritje të shqyrtimit gjyqësor. Në këtë mënyrë, sipas kërkesit, ai nuk ka pasur mundësinë për t'u ballafaquar me provat. Këtë pretendim shumica e ka analizuar në respekt të parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor, duke vlerësuar se edhe pse një pretendim i tillë ishte paraqitur në rekurs atij nuk i është dhënë përgjigje nga Gjykata e Lartë.

3. Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka ecur në linjën që, një vendim gjyqësor i dhomës së këshillimit cenon të drejtën për një proces të rregullt në ato raste kur në procesin e zhvilluar në shkallët më të ulëta të gjykimit është konstatuar cenimi i kësaj të drejte kushtetuese të individit, në një nga elementët përbërës të saj, por nëse Gjykata nuk konstaton cenim të së drejtës për një proces të rregullt në procesin gjyqësor të zhvilluar në të tri shkallët e gjykimit, ajo nuk mund të verë në dyshim procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, duke u mbështetur thjesht në faktin se Kolegji ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi.

4. Fakti që një pretendim për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor paraqitet formalisht nga palët në rekurs nuk është i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se vendimi i Kolegjit të Gjykatës së Lartë është i cenueshëm. Në një konkluzion të tillë Gjykata mund të arrijë vetëm nëse ajo vetë arrin të bindet mbi bazueshmërinë e pretendimit, pra mbi cenimin e një elementi të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në rekurs, të paktën formalisht, palët përpiqen të ngrenë para Gjykatës së Lartë shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Po ashtu, për efekt të shterimit të mjeteve ligjore të ankimit, çdo rekurs i paraqitur në Gjykatën e Lartë, formalisht përmban pretendime për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në mënyrë që ato të merren më pas në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese. Për këtë arsye, shqyrtimi i çështjes nga dhoma e këshillimit e Gjykatës së Lartë, nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por ai konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rastet kur Kolegji konstaton se shkaqet, pavarësisht nga mënyra e paraqitjes së

tyre, kanë të bëjnë me vlerësimin e provave e bindjen e brendshme të gjykatave të shkallëve më të ulëta apo me shkaqe që objektivist nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, ka të drejtë të mos e pranojë rekursin. Po ashtu, nëse Kolegji i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin se interpretimi që ka bërë gjykata e apelit, i cili është ai që kundërshtohet në rekurs, është i drejtë, është në kompetencën e tij të vendosë mospranimin e rekursit. Kjo është edhe përgjigja që i jep Gjykata e Lartë pretendimeve të ngritura në rekurs nga palët. Çdo qëndrim i kundërt do të vinte ndesh me qëllimin e ligjit për karakterin seleksionues të dhomës së këshillimit, për të kaluar në seancë vetëm ato çështje kur me të vërtetë në rekurs janë ngritur probleme ligjore. Për këtë arsye, vlerësimet që bën Kolegji në dhomën e këshillimit, nuk mund të përbëjnë *a priori* proces të parregullt ligjor dhe të passjellin kurdoherë shfuqizimin e vendimeve nga Gjykata Kushtetuese. Një qëndrim i tillë është në kundërshtim me përmbajtjen e dispozitave kushtetuese dhe do ta kthente padrejtësisht Gjykatën Kushtetuese në një instancë më të lartë gjykimi (*shih vendimin nr. 210, datë 27.12.2001 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Duke ju rikthyer çështjes konkrete, rezulton se në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese kërkesi ka paraqitur një sërë pretendimesh për procesin penal, të cilat janë rrëzuar nga shumica si të pabazuara. Referuar pretendimeve të paraqitura në kërkesë, dhe të evidentuara në vendim, cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit kërkesi e bazon në faktin se, gjykata e apelit, pavarësisht pretendimeve për pavlefshmërinë e provave të mbledhura gjatë fazës së hetimit si dhe faktit se ai është gjykuar në mungesë në shkallë të parë, nuk ka pranuar kërkesën për riçeljen e hetimit gjyqësor, çka nuk i ka dhënë atij mundësinë për t'u ballafaquar me provat.

6. Pretendimin për ligjshmërinë në marrjen e provave kërkesi e ka paraqitur edhe si pretendim më vete në kërkesë, duke qenë se është një nga elementët e procesit të rregullt dhe, shumica e ka gjetur të pabazuar. Në lidhje me të, shumica ka vlerësuar se “Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se jo për të gjitha provat, ku gjykatat kanë mbështetur vendimet e tyre, janë zbatuar me rigorozitet dispozitat e KPP-së në lidhje me marrjen e



tyre. [...] Gjykata është shprehur se për të përcaktuar nëse procesi ka qenë i rregullt, duhet kontrolluar nëse e drejta e mbrojtjes është respektuar dhe duhet verifikuar në veçanti nëse kërkuesit i është dhënë mundësia për të vënë në dyshim autenticitetin e provave dhe kundërshtuar përdorimin e tyre. Referuar çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe ajo e Apelit Vlorë arsyetojnë se për fajësinë e kërkuesit janë bazuar, jo vetëm në provat e kundërshtuara si të pavlefshme nga kërkuesi, por edhe në një sërë provash të tjera të administruara gjatë gjykimit, si provat materiale, shkresore, aktet e ekspertimit etj. Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkuesi nuk ka arritur të paraqesë argumente të mjaftueshme përse faktet e lartpërmendura i kanë cenuar të drejtën e mbrojtjes dhe që, për rrjedhojë, e bëjnë procesin të cenueshëm nga pikëpamja kushtetuese? (paragrafët 20-23 të vendimit).

7. Pra, edhe pse ka evidentuar disa mangësi në marrjen e provave, shumica ka vlerësuar se nuk ka pasur cenim të së drejtës për proces të rregullt. Jo vetëm kaq, por shumica ka rrëzuar edhe pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, duke argumentuar se gjykatat e faktit kanë paraqitur faktet dhe rrethanat e çështjes dhe provat ku mbështeten vendimet e tyre, si edhe pretendimin për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë. Por, pavarësisht këtyre përfundimeve të arritura prej saj, shumica ka vënë në dyshim vendimin e Kolegjit Penal me argumentin se nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit të ngritur në rekurs për mospranimin e kërkesës për përsëritjen e hetimit gjyqësor në gjykatën e apelit, kërkesë kjo e paraqitur nga mbrojtësi i kërkuesit për të kundërshtuar provat e pretenduara si të marra në mënyrë të paligjshme. Pra, sipas shumicës, Gjykata e Lartë ka detyrimin të marrë në shqyrtim dhe të shprehet për një pretendim të rrëzuar në thelb si i pabazuar. Në vlerësimin tim, do të kishte një vijueshmëri logjike në linjën e arsyetimit të vendimit vetëm nëse shumica do të kishte pranuar pretendimin për mënyrën e marrjes së provave mbi të cilat është bazuar vendimi gjyqësor, çka do të kishte sjellë për pasojë edhe cenimin e vendimeve gjyqësore që nuk e kanë pranuar atë, përfshi dhe vendimin e Gjykatës së Lartë, me argumentet e dhëna nga shumica.

8. Në vendimin e saj shumica arsyeton se “neni 427/4 i KPP-së parashikon se gjykata vendos

përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor kur vërtetohet se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në shkallë të parë, sepse nuk ka marrë dijeni ose nuk ka mundur të paraqitet për shkaqe ligjore. Gjykata, në rastin konkret, respektimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit e shpreh të lidhur ngushtë me detyrimin e Gjykatës së Lartë për të marrë në shqyrtim këtë pretendim si dhe, në respekt të parimit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, për t'i dhënë atij përgjigje. [...] Bazuar në sa më sipër, Gjykata çmon se është atribut i gjykatave të zakonshme të shqyrtojnë nëse në rastin konkret është zbatuar apo jo neni 427 i KPP-së. Gjithsesi, përderisa ky pretendim i kërkuesit lidhet me cenimin e standardeve kushtetuese, të tilla si e drejta e aksesit në gjykatë dhe barazia e armëve, në respekt të parimit të subsidiaritetit të lartpërmendur, Gjykata e Lartë detyrohet t'i jepte atij përgjigje. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Në përfundim, Gjykata vlerëson se disa nga shkeljet procedurale të konstatuara gjatë gjykimit gjejnë pasqyrim në dosjen gjyqësore dhe kanë të bëjnë me parime të rëndësishme të procesit të rregullt [...]” (paragrafët 43-47 të vendimit).

9. Bazuar në nenin 427 të KPP-së, gjatë gjykimit në gjykatën e apelit, kur një palë kërkon rimarrjen e provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor të shkallës së parë ose marrjen e provave të reja, gjykata në qoftë se çmon se një gjë e tillë është e nevojshme, vendos përsëritjen tërësisht ose pjesërisht të shqyrtimit gjyqësor. Sipas kësaj dispozite, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor vendoset edhe kryesisht kur gjykata e çmon të domosdoshme, si dhe kur vërtetohet se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në shkallë të parë, sepse nuk ka marrë dijeni ose nuk ka mundur të paraqitet për shkaqe ligjore. Gjykata ka theksuar se zbatimi dhe interpretimi i normës ligjore është së pari, dhe mbi të gjitha, funksioni kryesor i gjykatës. Në këtë kuptim edhe zbatimi i kësaj dispozite procedurale është diskrecion i gjykatës së apelit, pra është kjo e fundit që vlerëson nëse janë kushtet për të proceduar me riçeljen e hetimit dhe nënshkrimin ndaj tij të provave të kërkuara nga palët, veçanërisht në rastin e gjykimit në mungesë, në mënyrë që i pandehuri të jetë i pranishëm gjatë debatit gjyqësor dhe të verë në diskutim vlerën dhe provueshmërinë e provave të paraqitura nga akuzat.

10. Shumica jo vetëm që nuk ka arritur të evidentojë se interpretimi i nenit 427 të KPP-së ka sjellë cenimin e së drejtës për një proces të



rregullt ligjor të kërkuesit, por edhe pse çmon se është kompetencë e gjykatave të zakonshme interpretimi i kësaj dispozite, e pranon pretendimin e ngritur vetëm sepse, sipas saj, ai lidhet me cenimin e standardeve kushtetuese. Ky arsyetim i shumicës është, gjithashtu, i papranueshëm, pasi, siç përmenda edhe më sipër, palët formalisht mundohen t'i lidhin pretendimet e tyre me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt, por kjo nuk i bën ato apriori të bazuara. Megjithatë, shumica nuk është mjaftuar me kaq, por, pavarësisht sa më sipër, ajo ka bërë vetë interpretimin e dispozitës, duke marrë kompetencat e gjykatave të zakonshme, interpretim që e ka çuar në konkluzionin se mospranimi i kërkesës për përsëritje të hetimit gjyqësor përbën shkelje procedurale që gjen pasqyrim në dosjen gjyqësore procedurale (paragrafi 47 i vendimit).

11. Garancitë që i ofrohen të gjykuarit në mungesë kanë për qëllim që t'i japin mundësinë atij të mbrohet efektivisht ndaj akuzave të ngritura në momentin që njihet me procedimin penal të iniciuar ndaj tij. Në këtë kuptim, ligjvënësi ka parashikuar që në rast të gjykimit në mungesë në gjykatën e shkallës së parë, i pandehuri mund të kërkojë përsëritjen e hetimit gjyqësor me qëllim të marrjes së provave të reja apo kundërshtimin e provave të administruara në atë gjykim. Kjo sepse legjislacioni procedural i garanton të pandehurit mundësinë e pjesëmarrjes aktive në gjykim. Pavarësisht se interesat e të pandehurit në gjykimet e faktit mbrohen, si rregull, me avokat, ai nuk pengohet për të paraqitur dhe kundërshtuar vetë provat, për të bërë pyetje dhe për të dhënë vetë sqarime, apo për t'u shprehur për aspekte të përgjithshme dhe të veçanta të procesit të cilat i vlerëson si të rëndësishme. Po ashtu, deklarimet e të pandehurit në seancë shërbejnë për të saktësuar e sqaruar më mirë mjaft elemente të veprës penale.

12. Gjykata ka theksuar se respektimi i secilit parim të procesit të rregullt duhet vlerësuar rast pas rasti dhe në varësi të rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim. Bazuar në aktet e dosjes gjyqësore rezulton se gjykimi i kërkuesit në gjykatën e shkallës së parë është bërë në mungesë të tij dhe ai është përfaqësuar nga një mbrojtës i zgjedhur, me prokurë të posaçme, nga familjarët. Pas ekstradimit të kërkuesit në Shqipëri, kërkuesi,

duke qenë se kishte në dispozicion mjete ankimi ndaj vendimit të shkallës së parë, ka paraqitur kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, e cila është pranuar, përfundimisht, nga Gjykata e Lartë. Në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Apelit Vlorë, mbrojtësi i kërkuesit ka kërkuar riçeljen e hetimit gjyqësor, kërkesë që nuk është pranuar me arsyetimin se *“veprimet hetimore që kërkonte avokati të kryeshin ish-in kryer gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe nuk ishin kërkime të bëra në këtë gjykim apo të refuzuara pa ndonjë shkak të ligjshëm nga gjykata”*. Pas ekstradimit të tij në Shqipëri, duke zgjedhur të përfitojë nga shërbimet e të njëjtut mbrojtës të zgjedhur nga familjarët e tij, kërkuesi ka njohur dhe pranuar të gjitha veprimet e kryera prej tij. Po ashtu, kërkuesi ka zgjedhur me vullnet të lirë të mos marrë pjesë në procesin penal të zhvilluar në gjykatën e apelit, duke zgjedhur po me vullnet të lirë të njohë të gjitha veprimet procedurale të kryera nga mbrojtësi i tij. Në këto kushte, vlerësoj se zbatimi i parashikimit të nenit 427/4 të KPP-së nuk mund të sillte asnjë efekt për kërkuesin duke qenë se ai ka vendosur të mos përfitojë nga kjo garanci.

13. Në përfundim të qëndrimit tim në pakicë dua të ritheksoj se Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 131/ç të Kushtetutës, është kompetente për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për një proces të rregullt ligjor. Në këtë kuptim, i takon kësaj Gjykate të vendosë nëse pretendimet e paraqitura në kërkesë janë të bazuara dhe, pra, nëse ka pasur cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Veçanërisht kur pretendimet e palëve lidhen me shkelje procedurale gjatë procesit dhe jo me mënyrën e zbatimit apo interpretimit të ligjit material, Gjykata nuk ka asnjë pengesë të vlerësojë mbi bazueshmërinë e këtyre pretendimeve. Nëse nuk arrin të evidentojë një shkelje të tillë, Gjykata nuk mundet të vendosë *apriori* cenimin e vendimit të Kolegjit të Gjykatës së Lartë vetëm me arsyetimin se rekursi është shqyrtuar në dhomë këshillimi dhe se pretendimet e ngritura në të janë nga ato të parashikuara nga ligji. Vlerësimi i ekzistencës së shkaqeve ligjore në rekurs është kompetencë e dhomës së këshillimit dhe nuk mund të bëhet kurrsesi objekt i vlerësimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Edhe pse vendimet e dhomës së



këshillimit kanë një formulë *de plano* arsyetimi, e cila si nga Gjykata ashtu edhe nga GJEDNJ-ja është vlerësuar se plotëson kërkesat e procesit të rregullt, kjo nuk do të thotë se pretendimet e ngritura në rekurs nuk janë marrë në shqyrtim, por se ato kanë qenë haptazi të pabazuara dhe Gjykata e Lartë është shprehur mbi to nëpërmjet vendimit të dhënë në dhomën e këshillimit. Duke mbajtur qëndrime të tilla, tashmë në disa vendime të sajat, vlerësoj se Gjykata po ndërhyt në kompetencat e Gjykatës së Lartë, duke i hequr asaj, në mënyrë indirekte, një kompetencë të rëndësishme siç është ajo e vlerësimit paraprak në dhomë këshillimi.

Anëtare: Altina Xhoxhaj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja “Kristalina”
Tiranë, 2014

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 20 lekë